

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH			
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	01	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	05-5084
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -	Data: Date:	01 07 2024
Prishtinë / a			



**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health  
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/ Office of dhe Minister

**Nr. 125/VII/2024**

**Datë: 01.07.2024**

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare Nr.7.01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregulloren (QRK) Nr.14/2023, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Shtojca 1 paragrafi 6 nënparagrafi 6.1, bazuar në nenin 7 Ligjin Nr. 08/1-220 Për çmimin e produkteve medicinale, sipas propozimit nga Komisioni për përcaktimin e çmimeve me emalin e datës 24.06.2024, nxjerrë:

**V E N D I M**

~~Për shpalljen e afatit për sjelljen e dëshmimeve për çmimin e importit CIP~~

1. Obligohen Bartësit e Autorizim Marketingut (BAM) të deklarojnë çmimin e importit CIP, së bashku me dëshminë nga Dogana e Republikës së Kosovës (DUD) apo Lejen e importit të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për produkte dhe pajisje medicinale.
2. Afati për deklarimin e çmimit të importit CIP është 5 ditë duke filluar nga 04.07.2024 deri më 19.07.2024.
3. Në rast se BAM nuk sjell dëshminë sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, Komisioni për përcaktimin e çmimeve ka për obligim të hulumtojë/verifikojë çmimin e importit CIP nga institucionet përkatëse.
4. Për produktet medicinale që janë të regjistruara nga BAM në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje medicinale dhe nuk janë importuara nga BAM duhet të sjellin profaturë ose faturë.
5. Obligohet Komisioni për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale për zbatimin e këtij vendimi dhe të përcaktoj çmimin e produkteve medicinale në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



**Dr. Arben Viti**  
**Ministër i Shëndetësisë**

Vendimi u dërgohet:

- Znj. Virtyte Krasniqi;
- Zëvendësministratve të MSh;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- AKPPM;
- Departamenti ligjor;
- Arkivit të MSH-së.